



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr.“Dëshmorët e Kombit” p.n.

MEMORANDUM SHPJEGUES

Për: Prezantimin e Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese në kuadër të Hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Ferizajt

Hyrje

Komuna e Ferizajt, në përputhje me Ligjin për Planifikimin Hapësinor nr. 04/L-174 dhe aktet përkatëse nënligjore që rregullojnë pjesëmarrjen dhe konsultimin publik, është duke zhvilluar procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK).

Ky plan përbën një dokument strategjik thelbësor që orienton zhvillimin afatgjatë hapësinor, ekonomik dhe social të komunës.

Në këtë kuadër, është përfunduar faza e vlerësimit të gjendjes ekzistuese, e cila përfshin analizën e situatës aktuale në aspektin urban, infrastrukturor, mjedisor dhe socio-ekonomik. Për të siguruar transparencë dhe përfshirje të gjerë të publikut, Komuna organizon një sesion publik për prezantimin e këtij vlerësimi.

Qëllimi

Qëllimi i këtij memorandumi është të informojë dhe të inkurajojë pjesëmarrjen aktive të qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile, bizneseve, ekspertëve dhe palëve të tjera të interesit në procesin e konsultimit publik.

Sesioni publik synon:

- Të prezantojë në mënyrë të qartë dhe të strukturuar gjetjet e Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese të Planit Zhvillimor Komunal.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr.“Dëshmorët e Kombit” p.n.

- Të ofrojë mundësi për diskutim të hapur dhe shkëmbim të ideve ndërmjet pjesëmarrësve.
- Të mbledhë komente, sugjerime dhe rekomandime që do të kontribuojnë në përmirësimin e dokumentit final të PZHK-së.
- Të sigurojë një proces gjithëpërfshirës dhe transparent të planifikimit zhvillimor në nivel komunal.

Pjesëmarrja juaj është thelbësore për ndërtimin e një vizioni të përbashkët dhe të qëndrueshëm për zhvillimin e ardhshëm të Komunës së Ferizajt.

Përfundim

Prezantimi i Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese në kuadër të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Ferizajt është një dokument me rëndësi të veçantë për qytetarët e Ferizajt.

Ky dokument do të jetë në konsultim publik nga data **04.05.2026**, ndërsa takimi konsultativ me qytetarë do të mbahet më **12.05.2026**, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora **10:00**.

Komentet dhe sugjerimet tuaja mund t'i dërgoni në:

- Email: arbër.bytyqi@rks-gov.net
- Në formë fizike në adresën: **Rruga “Dëshmorët e Kombit” pn, 70000 Ferizaj**, ose në Zyrën për Shërbime me Qytetarë

Burime dhe informata shtesë

- Konsultimet publike: <https://ferizaj.rks-gov.net/konsultimet-publike/>



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr.“Dëshmorët e Kombit” p.n.

- Njoftime: <https://ferizaj.rks-gov.net/konsultimet-publike/?tax=njoftimet-konsultime-publike>
- Planet: <https://app.insi-ks.com/en>
- Procesverbalet dhe raportet: <https://ferizaj.rks-gov.net/konsultimet-publike/?tax=raporte-konsultime-publike>